

SHKODRA E SIMINËVE GJATË GJYSMËS SË DYTË TË SHEKULLIT XIX

Prof. asoc. Dr ALMA HAFIZI

Universiteti "Luigj Gurakuqi"

alma.hafizi@unishk.edu.al

ABSTRACT

The paper is a reflection on the book *Un patriota leccese in Albania Ottomana* written by Giacinto Simini and concerning the revolutionary uprisings that involved Southern Italy against the Kingdom of the Bourbons in 1848, in which the author's father, Gennaro Simini, took part. Forced into hiding due to the persecutions, he moved from Lecce to Albania, in Scutari, the city where Simini practiced his profession as a doctor and where spent all the rest of his life. The author reports the memories from his father's confessions, serving many bibliographic references on the vision of Scutari at the time, the diplomatic life of Scutari which at the time hosted the representations of the major European states. An apparently simple memoir evokes many events and characters and can serve as a guide for the cultural promotion of the city. Many of the objects evoked do not exist today, therefore the analysis of this text is an appeal to political-cultural institutions at local and central level. Informative signs where these objects once existed could help rebuild our cultural identity, as the identity is also built through the places we visit.

Keywords: *collective memory, literature, cultural references, cultural identity, history, territorial and tourism promotion, cultural heritage.*

Libri *Un patriota leccese nell'Albania ottomana*¹, botuar në Itali nën kujdesin e studiueses Mirella Galletti, me parathënie nga historiani Franco Cardini, përmban një dorëshkrim për jetën afro shtatëdhjetëvjeçare të doktor Gennaro Simini (1812-1880), shkruar nga

¹ Simini Giacinto (2011), *Un Patriota Leccese Nell'Albania Ottomana*, Argo

i biri Giacinto. Dorëshkrimi u gjet rastësisht në arkivat e familjes Simini prej stërmbesës Roberta dhe koleges së saj e njëkohësisht redaktores së librit, historianies Galletti, e cila e shoqëron me një studim të thukët, ku jepet sfondi historik i Italisë dhe i Ballkanit në atë kohë, si dhe sillen dokumente arkivore për veprimtarinë e doktor Siminit. Në vitet e turbullta të lëvizjes për bashkimin kombëtar (1821-1848), shumë italianë të përndjekur nga regjimi i burbonëve gjetën strehim të përkohshëm në trojet shqiptare, sidomos në qendrat më të zhvilluara të kohës si, Gjirokastër, Tiranë, Shkodër.

“Një familje italiane me gjak shqiptar ndër vena”

Kështu i pati folur Koliqit për familjen Simini një personalitet i shquar italian gjatë një tubimi kulturor, një përcaktim konciz për një familje krejtësisht italiane, e lidhur me një rrjet të dendur martesash me Shqipërinë e veçanërisht me Shkodrën.²

Gennaro Simini, biri i një burri të fisëm, Giacinto dhe i Arcangela Guarino-s, lindi në Monteroni të Leçes me 6 dhjetor 1812 dhe vdiq në Shkodër me 9 prill 1880. Kreu studimet e para në Leçe, më pas në Napoli, ku u diplomua me 1834 në gjuhë e Filozofi dhe me 1836 në mjekësi e kirurgji. Njihte mirë frëngjishten, anglishten dhe shqipen. Besnik i ideve maciniane, bashkëpunoi fort për bashkimin kombëtar, një ndër organizatorët e lëvizjeve revolucionare që u përhapën në zonën e Leçes me 1848 kundër monarkisë së burbonëve. U akuzua për komplot kundër Mbretit dhe pas disa muajve në ilegalitet në jug të Italisë, me 4 qershor 1851, së bashku me Oronzo de Donno-n u largua nga Brindizi për në Korfuz, asokohe nën protektoratin britanik të ishujve jonianë, ku jetonin disa patriotë italianë mes të cilëve dalmati Niccolò Tommaseo.

Jeta e Simini-t shënohet nga episode aventuriere dhe të spikatura. Ashtu sikundër i gjithë komuniteti i mërgimtarëve italianë edhe Simini u ndje keq në Korfuz pas përhapjes së lajmeve të rreme, mashtrimeve

²Koliqi Ernest (2003), *Familja Simini*, në “Vepra 6”, Prishtinë, Faik Konica, fq. 604-621
Simin-ët kanë pasë lidhje krushqie me familjet shkodrane Vasaj, Muzhani, Dodmasej, Preka, Suma (Heqimi), Bjanku, Ashiku, Shiroka, Mazreku, Shestani, Zorba, Gjemarkaj.

të ngritura me aq art nga kush kishte interes, rreth një ndihme të italianëve pro Turqisë në luftën kundër Rusisë. Për rrjedhojë, bashkë me dy shokë të tjerë, avokatin De Donno dhe Xhuzepe Vittoli, në vitin 1853 Simini largohet përgjithnjë nga Korfuza dhe mbërrin në Durrës e më pas vendoset në Shkodër. Fillon kështu jeta shqiptare pa kthim e këtij patrioti italian.

Tre italianët udhëtonin në trojet shqiptare me dokumente identiteti të lëshuara prej komisarit britanik të ishujve jonianë, Lord H.G. Ward. Në Durrës ata nuk e gjetën veten të sigurt për shkak të pranisë së ndjeshme austriake dhe vendosën të nisen në Shkodër. Bujtën tek një bajraktar vendas në zonën mes Durrësit dhe Lezhës, thuhet në dorëshkrim, por sipas përshkrimeve rezulton të jetë përafërsisht zona e Ishmit.³ Mikpritësi anonim duket se ka qenë drejtues i rëndësishëm i administratës lokale osmane, i besimit mysliman, i kamur ekonomikisht, i prezantuar si mik i Sulejman agë Hotit, autoritet i njohur në Shkodrën e asaj kohe nga bajraku i Veriut të Shqipërisë, tek i cili i drejtoi tre italianët për çdo lloj ndihme me të arritur në Shkodër. Pas tre ditësh arritën në Shkodër.

Zëvendëskonsull austriak në Shkodër asokohe ishte Vincenzo Ballarini “tradhëtar i origjinës italiane” që kërkoi me çdo kusht t’i arrestonte dhe t’i dorëzonte pranë qeverisë së tij tre mërgimtarët. Ata u morën në mbrojtje nga beu i famshëm dhe i pushtetshëm Sulejman agë Hoti, i cili i dërgoi sipas rekomandimit të Pashait vetë, qeverisë së Shkodrës, tek konsulli i përgjithshëm anglez Spiridone Bonatti, me origjinë veneciane dhe “ndjenja të forta italiane”, “krenari e emigracionit të hershëm Italian”. Bonatti i deklaroi të mbrojtur nga Qeveria angleze. Të tre patriotët u përshtatën mirë me realitetin shqiptar. Giuseppe Vittoli hapi një shkollë me pagesë e ndjekur nga fëmijët e familjeve më të mira katolike. Avokati Oronzo De Donno u bë popullor si mbrojtës i të shtypurve, por i kërcënuar nga konsulli austriak që kërkoi largimin e tij si të pa dëshiruar. Por kjo manovër u shmang me zotësi nga Bonatti që e emëroi përkthyes pranë konsullatës angleze.

³ Simini Giacinto (2021), *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*, përkth. nga origj. Alma Hafizi, Tiranë, Berk, fq.132

“Kapërcyen male të tmerrshme e të vetmuara, pyje pa fund dhe duke lënë pas lumenj e ujëvara të larta arritën nga mbrëmja, pas një udhëtimi të gjatë në kalë, tek shtëpia e një beu.”

Doktor Gennaro Simini në Shkodër

Doktor Simini filloi të ushtronte profesionin e tij, gjë që e vazhdoi për njëzetetë vite. Shërbimet mjekësore për popullatën kryheshin në mënyrë empirike. Mjekët e paktë që kishte Shkodra, kryesisht të ardhur nga Dalmacia, Italia, shërbenin pranë vezirëve. Simini ishte patolog dhe bënte operacione të vogla kirurgjikale. Mendohet se është i pari mjek që ka bërë operacionin e kataraktit në Shkodër.⁴ Fitoi menjëherë besimin dhe respektin e mbarë popullit, katolikë dhe myslimanë. Vetë Pashai i Shkodrës dhe madje princesha e Malit të Zi kërkuan ndihmën e doktor Siminit.

Në atë kohë në Ballkan plasi një epidemi e madhe kolere. Shumë mjekë nga vende të tjera të Evropës vizitonin rajonin për të studiuar sëmundjen. E kështu erdhën në Shkodër dy mjekë austriakë. Aftësia e Siminit për të diagnostikuar u vlerësua nga dy mjekët vjenetzë që, pas konsultës me një paciente të tij, ishin plotësisht në një mendje me praktikën e ndjekur prej doktorit duke pohuar: “Sa keq që ai ndodhet këtyre anëve!”⁵

Sipas dorëshkrimit, doktor Simini-n “e shihje hipur mbi kalin e bardhë, nëpër rrugët e qytetit, gjithë ditën, deri në orët e vona të mbrëmjes, duke vizituar njeri pas tjetrit të sëmurët, të cilëve kur ishin edhe të vobektë u siguronte falas barnat nga farmacia e tij, u dërgonte dru, qymyr dhe u jepte para, me të cilat të mund të blinin mish për t’i marrë lëngun.”⁶ Ai ishte “shenjtori i nevojtarëve”. Populli e quante me përkëdheli doktor Jasemini. Emri i tij rezulton shpesh në librat e kishës si dëshmitar martese.

Realizoi reklamën e parë shqiptare me Marubin, një fotomontazh ku i biri i Siminit, Giacinto, shfaqet në tre pozicione të ndryshme, njëri me këmbë të prerë të cilën e mban në krah, i dyti mjeku me sharrë në dorë, mjeti i operimit, dhe i fundit, i veshur me kostum popullor shkodran me dorën e shtrirë drejt spitalit ku i fton njerëzit për të shkuar e për t’u shëruar.⁷

⁴ Kerçiku Kadri(1962), *Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shek. XVIII-XX*, Tiranë, fq.206

⁵ Simini Giacinto (2021), *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*, vep.cit...,fq.138

⁶ Po aty...fq.142

⁷ Fotot janë të aksesueshme në Muzeu kombëtar i fotografisë “Marubi”:

<https://encrypted-tbn0.gstatic.com/images?q=tbn:ANd9GcTE8rdosx5ZNc6hK5eCtZaUn8Z6->

Po cila ishte Shkodra që gjeti Simini në mesin e shekullit XIX?

Kur piktori i shquar anglez Edward Lear⁸ vizitoi Shkodrën në tetorin e viti 1848, ai priste të shihte qytetin në të majtë të kodrës vetmitare që ndante liqenin nga fusha, mbi kreshtën e së cilës ngrihej fortësa hijerëndë. Por ishte e gjitha një iluzion mashtrues, mure shtëpish të rrënuara, lagje të brakstisura. Lear shkruan: “Teksa ngjitesh përmes kësaj skene të shkretuar për tek rrugët e gjata me dyqane që bashkohen poshtë fortësës hijerëndë [...] befasohesh kur e kupton se ende nuk ke hyrë në Shkodër. [...] në atë që është qyteti i vërtetë i Shkodrës (i njohur me emrin ‘Kopshtijet’).”⁹ Nga planet urbanistike historike të Shkodrës rezulton se evolucioni i qytetit ka njohur dy faza. E para kur qyteti mesjetar shtrihej rreth kështjellës, dhe e dyta, kur për shkaqe të fatkeqësive natyrore si, përmbytjet nga Drini dhe rreziku i kënetëzimit të zonës, për shkak të zhvillimit ekonomik e kulturor, në kapërcyell të shekujve XVI-XVII shpërngulet drejt lagjes Tophanë e më vonë, fundshekulli XVIII e mesi i shekullit XIX, drejt lindjes e juglindjes duke përfshirë lagje që deri asokohe ishin konsideruar si katunde të shkëputura nga qyteti, Gjuhadoli e Rrëmaji.¹⁰

Në hovin që karakterizoi zhvillimin ekonomik, pikërisht në mesin e shekullit XIX, vjen Simini në Shkodër. Ai gjen një bukuri natyrore që i ka falur Zoti këtij qyteti dhe që sot akoma i qëndron si margaritar. Ky aset natyror, i cili nuk kalon pa marrë vëmendjen e shumë vizitorëve të kësaj periudhe nuk ceket specifikisht në dorëshkrim, por zgjedhja e Siminëve për të qëndruar në Shkodër edhe pas qetësimit të situatës në Itali është provë e prehjes shpirtërore që ky vend e kjo natyrë i ofronte. Peizazhet që Lear ka përjetësuar në pikturat e tij dëshmojnë se “pamja ishte e mahnitshme”, një urë e vjetër e mrekullueshme mbi Bunë (sot nuk ekziston), me harqe të larta me majë, me gjerësi të ndryshme “të cilat dukeshin si kolona katedralesh gotike që papritur kishin vendosur të kalonin lumin, ca me hapa të shkurtra e ca më të

KjcZSXT 158U52p&s

⁸ Lear u akomodua në shtëpinë e konsullit britanik në Shkodër, Zotit Bonatti. Nga qendrimi disa ditor i bëri një portret vajzës së dytë të shtëpisë, Caliopi bonatti, motra e Elenës, bashkëshortes së Siminit.

⁹ Lear Edward (2008), *Edward Lear në Shqipëri. Ditar udhëtimesh 1848-1849*, Tiranë, Plejad, fq.101

¹⁰ Kamsi Willy (1994), *Monumentet e traditës në Shkodër*, në “Seminari i parë ndërkombëtar ‘Shkodra në shekuj’, 22-23 qershor 1993, fq. 145-149

gjata", një tablo madhështore që shtrihej nga shkëmbi i lartë në lindje të Pazarit të vjetër (kodra e Tepes, monument natyre me vlera të veçanta shkencore, didaktike e kulturore) që rrokte kalanë, majat e larta të maleve, rrënojat e qytetit poshtë, lumin që gjarpëronte poshtë urave diku tutje dhe dielli i zhytur në horizont që përflakte anën veriore të këtij peizazhi duke krijuar mrekullinë e pashoqe me "gjethnajat e harlisura dhe ndërtesat xixëlluese nga njëra anë, dhe vargjet e kodrave me ngjyrë të kaltër dhe vjollcë të errët në sfondin e ndriçuar"¹¹.

Hartografi dhe gjeografi francez Guillaum Lejean, gjatë udhëtimeve të tij në Ballkan (1857-1870), mbante letërkëmbim të rregullt me miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij. Njëra prej tyre ishte zonja Marie Souvestre së cilës, në letrën e datës 29 qershor 1869 i shkruan nga Shkodra se: "U ktheva nga një shëtitje në male dhe u thashë shkodranëve të habitur se ka, katër lega nga qyteti i tyre, një Zvicër shqiptare, plot me mrekulli, për të cilën as u kishte shkuar në mendje: liqene, përrenj, lugina të shkëlqyera."¹²Duke pasë parasysh se një legë franceze konvertohet me afërsisht katër kilometër, flitet për një distancë të përafërt me gjashtëmbëdhjetë apo njëzet kilometër. Është fjala për malësitë në pjesën lindore të qytetit, që kanë befasuar dikur edhe me qytetërimin e tyre, ndërsa sot kanë rimarrë vëmendje si atraksione natyrore, për Sardën e famshme mesjetare, për liqenin e bukur të Vaut të Dejës, për kanionet e krijuara prej lumit Kir, ku më i veçanti është ai i "Urës së Shtrenjtë" siç e tregon edhe vetë emri.

Rrethanat e krijuara nga statusi i mërgimtarit, ashtu sikundër edhe profesioni i Siminit në shërbim të popullit, nuk i krijuan mbase hapësirat e nevojshme për eksplorimin e natyrës përreth, por për diçka ishte tejet i sigurt, që kishte ardhur në një qendër tregtare e diplomatike që gëlonte.

Shkodra qendër e tregtisë dhe diplomacisë rajonale

Në vitin 1853 Shkodra ishte kthyer në një farë qendre diplomatike rajonale. Aty përplaseshin interesa, edhe të mprehta, kryesisht midis administratës osmane dhe qeverisë austro-hungareze, që po zgjeronte

¹¹ Lear (2008), vep.cit...fq.108

¹² Lejean Guillaume (2011), *Udhëtimeve në Ballkan (1857-1870)*, Dituria, fq.391

ndikimin e vet në atë pjesë të Ballkanit. Natyrisht rajoni, për arsien e mësipërme, por edhe për rëndësinë strategjike, politike dhe ekonomike të veçantë, si dhe fqinjësinë me Malin e Zi, tërhiqte vëmendjen edhe të Britanisë së Madhe, Rusisë, Francës.

Në Shkodër gjejmë fillimet e para të zhvillimit kapitalist të vendit, si shkëmbimet në fushën e tregëtisë me qytetet mesdhetare, me manufakturat e para. Që nga mesi i shek. XIX ekzistonin mjaft përfaqësi tregtare të huaja (vetëm me Triesten mbanin lidhje gjashtëdhjetë firma të qytetit). Pazari deri nga vitet 1870 luante një rol të rëndësishëm në Ballkan dhe në hyrje të tij ishin të ndërtuara në atë kohë tridhjetë e dy hane për strehimin e tregtarëve.¹³ Pazari përbënte pjesën më interesante dhe më laramane të qytetit nga i cili ishte vetëm pesëmbëdhjetë minuta larg. Ai bënte bashkë tregtarë nga e gjithë Shqipëria, si ura lidhëse midis Evropës dhe pjesës perëndimore të Perandorisë osmane deri në krijimin e linjës hekurudhore që bashkonte Evropën me brendinë e Turqisë. Shkrimtari, gazetari e diplomati i njohur serb Nishiq shkruan për Pazarin e Shkodrës: “Aty i sheh malësorët, aty serbët e Vrrakës, aty latinet e bukura [...] aty sheh evropianin me sheshir (republikë), fratin me fytyrën e rruar, hoxhën nën turban dhe priftin nën kamillaf; [...] kjo i jep një hijeshi të veçantë pazarit të Shkodrës.”¹⁴ Deti gjithashtu i sillte kësaj qendre tregtare pasuritë e të gjithë botës çka reflektohej në mirëqenien e shkodranëve dhe në veshjet e begata të tyre. Sllavisti suedez Alfred Jensen gjatë turit të tij nëpër Ballkanin jugperëndimor kaloi vetëm një ditë e një natë në Shkodër dhe kujton se u shoqërua nga një shkodran i ri, i veshur mirë me kostum evropian, që fliste mirë greqisht, italisht, turqisht përveçse shqip, e se nga vendet e vizituara si kalaja e Rozafatit, një varrezë myslimane, nuk anashkaloi pazarin me lagjet përreth.¹⁵ Aty zhvillohej jeta sociale që nga lindja e deri në perëndim të diellit, për t’u shpërngulur më pas drejt qytetit. Në dorëshkrimin e Siminit nuk kalon pa u vënë re një detaj, në dukje i parëndësishëm por në thelb domethënës. Ditën që doktori i nderuar

¹³ Luzati Skender (1998), *Ndërtimi dhe arkitektura e Shkodrës gjatë shekujve*, në “Seminari i dytë ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, 22-23 qershor 1995, vëllimi I, fq. 253-261

¹⁴ Nushiq Branislav (2021), *Nga Kosova deri në bregdetin Adriatik. Shënime udhëtimi nëpër viset shqiptare në vitin 1894*, Naimi, fq.181

¹⁵ Qvick Ullmar (1998), *Shkodra në botimet e vizitorëve suedezë*, në “Seminari i dytë ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, 22-23 qershor 1995, vëllimi I, fq. 173-179

mbajti frymën e fundit për t' u larguar drejt përjetësisë, të gjithë dyqanet u mbyllën për ta përcjellë drejt banesës së fundit, sikur u paralizua e gjithë jeta e qytetit në shenjë nderimi e respekti për veprën e Siminit. Dëshmitë e shumë vizitorëve të huaj flasin për këtë qendër tregtare të pazakontë për nga funksioni si për një tipar identifikues të Shkodrës në shekujt e kaluar. Prej dekadash kjo qendër nuk ekziston më. Me tërbim këmbëngulës u shkatërrua Pazari dhe me po aq fanatizëm u punua sistematikisht për të mos e kujtuar atë të kaluar të ndritur që e mbante Shkodrën lidhur me Lindjen e me Perëndimin, duke zhdukur çdo provë, dëshmi, monument që të mund ta sillte në kujtesë atë. Dhe ashtu siç thuhet, një vend që nuk ka kujtesë, nuk ekziston.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Shkodër kishin selitë e tyre pesë konsullata të vendeve evropiane. Prania e përfaqësive diplomatike përkthehet në hop të zhvillimit ekonomik, që reflektohet në modernizimin e jetës së komunitetit, të zhvillimit urbanistik, të ndryshimeve të gjeografisë sociale të qytetit (pasurimin me komunitetet e huaja). Konstatohet prania e komunitetit relativisht të gjerë italian, komunitetit të të krishterëve ortodokse nga Korfu, mes të cilëve edhe dy figura të shquara për historinë e kulturën e Shkodrës si Pietro Marubi e Kol Idromeno.

Historia e veprimtarisë diplomatike të asaj kohe në Shkodër është fragmentare. Sado e studiuar të jetë nga personat e interesuar për këtë fushë, ajo mbetet e tillë që në momentin që nuk ka njohuri të unifikuara për vendndodhjen e selive të përfaqësive diplomatike të kohës. Natyrisht që ato u vendosën në të ashtuquajturën qendër të qytetit për kohën siç ndodh rëndom për natyrën e veprimtarisë që zhvillojnë. Kureshtarë për faktin u informuam pranë disa guidave turistike nëse e ofronin si itinerar turistik bllokun e ndërtesave të selive diplomatike. Përgjigja ishte negative. Dhe jo vetëm që nuk ka përpjekje për ta dëshmuar këtë fakt, por edhe vendndodhja e tyre në burime të ndryshme nuk është e saktë. Studiuesi Lucian Bedeni¹⁶ ka mundur të identifikojë fotot e selive diplomatike të aksesueshme në Muzeun kombëtar të Fotografisë “Marubi” në Shkodër.

Pesë selitë e përfaqësive diplomatike të vendosura në Shkodër në periudhën që cek dorëshkrimi i Simini-t janë ajo franceze (nuk

¹⁶ Bedeni Lucian (2021), *Foto-Studio ‘Marubbi’ shpi themelue në 1856 : (Pietro Marubbi dhe lindja e studios së parë fotografike në Shqipëri)*, Tiranë, fq.320, disertacion i konsultueshëm në sallën e Bibliotekës kombëtare Tiranë.

ekziston sot), e vendosur në qendrën e atëhershme dhe të tanishme të qytetit, në rrugën pedonale (piaca), godina e ish “Grand hotel” ose siç njihet nga shkodranët ish “Turizmi i vjetër”. Vendi ku ngrihej godina gjatë viteve të diktaturës u kthye në lulishte, birrari e sot akoma ofron shërbime sociale bar e restorante. Vendndodhja e ish hotel turizmit është trashëguar gojarisht, asnjë shënim, tabelë që të mund të rievokojë diçka nga e kaluara, duke qenë se godina kishte domethënie për historinë e Shkodrës. Përballë saj ekziston një rrugë, e quajtur Rruga e Etërve Jezuitë në hartën britanike (1913) dhe në atë të Etërve Jezuitë (1923), rruga e Kafes së Madhe në vitet e monizmit, ku ndodheshin konsullata e Austrisë, në shpinë të saj ajo e Rosisë, pranë së cilës u sistemua Pietër Marubi¹⁷ në fillimet e jetës së tij shkodrane, i ngarkuar për zbukurimin e kishës ortodokse ndërtuar në truallin ngjitur saj (1861), e për të cilën kishte kontribuar me një dhuratë, ikonë të çmuar, familja e Romanovëve. Godinat e selive ekzistojnë edhe sot, kanë qenë shtëpi banimi, por për funksionet e mëparshme informacioni i besohet memories individuale.

Në pjesën fundore, djathtas rrugës, shtrihej kompleksi i Jezuitëve (seminari Papnor, Kolegji Saverian, orfanotrofi) dhe në shpinë të tyre Konsullata e Italisë. Në rrugicën e Sumajve, thuajse përballë kompleksit Jezuit që ndaheshin nga rruga kryesore që lidhte Pazarin me pjesën lindore të qytetit, ndodhej Konsullata Britanike¹⁸, ngjitur me shtëpinë ku banonte patrioti Pashko Vasa, i punësuar pranë saj e më pas edhe dhëndër i familjes Bonatti (u martua me vajzën e madhe të konsullit britanik Spiridone Bonatti). Familjet e konsujve banonin në të njëjtat shtëpi që funksiononin edhe si seli diplomatike. Ata ishin ndërtime të stilit perëndimor dhe oriental, tepër mbresëlënëse për nga bukuria dhe madhështia, me pronarë të përmendur për mirëqenien e tyre

¹⁷ Sipas studiuesit Bedeni L., vep.cit.

¹⁸ Ndodhej në Shtëpinë e të birëve të Kolë Heqimit, e shpallur shtëpi muze për bukuritë antike që përmbante, por për motive urbanistike (zgjerim rruge) në vitet 1960 u shkatërrua. Qemeri i derës dhe harku i sipërm i saj ishin prej guri të latuar. Anash saj dy dritare qorre. Oborri i mbjellë me manjollë, hurma dhe lule gjithfarë ngjyrëshe, pusi i madh prej guri me dekoracione dhe lugu i gurtë për larje. Shkallët e hyrjes të gurta me parmakë të punuar. Qardaku prej druri, tavanet me thurje në formë rombesh që përmbajnë lule pesëgjethëshe të daluara. Trapazani me dritare romboidale dhe në mes kafazlije. Oxhaku madhështor me dy rosona sipër, dhomë miqsh për të cilën flet edhe Edith Durham në *Brenga e Ballkanit*. Pas prishjes, oxhaku dhe punime të tjera artistike u dërguan në shtëpinë muze të patriotit Luigj Gurakuqi.


Suma Terezina (2003), *Familja Suma, histori, traditë*, Familja Suma, histori, traditë, etikë, Florimont, fq.72

ekonomike. Përfaqësitë diplomatike në Shkodër, në kohë të ndryshme kanë ndërruar seli, por ne i referohemi viteve 1853- 1880 për të cilat flitet në dorëshkrimin e Simini-t.

Nga harta më poshtë (foto 1.) mund të vihet re se qyteti ka tendencën të zhvillohet nga lindja, ashtu sikundër edhe kompleksi i institucioneve të kultit katolik zgjerohet asaj ane, duke e ndarë qytetin përgjysmë sipas përkatësisë fetare (lagjet myslimane nga perëndimi e ato katolike nga lindja). Nuk është e qartë se ku banoi vetë Simini. Studiuesi Bedeni mendon se ai mund të ketë banuar në zonën e ndërmjetme mes asaj myslimane e katolike, aty ku pak më vonë fillon të ngrihet qendra e re tregtare e njohur si “Dugajtë e reja” (akoma sot ekzistuese, por mungon simboli i saj, “Truma e dugajëve të reja”). E nëse diçka e tillë do të provohej, do ta përforconte më tepër perceptimin e Siminëve mbi bashkëjetesën fetare në Shkodër, si vlerë e trashëgimisë sonë jomateriale.

Më 1856 Simini u martua me Elena Bonatti-n, vajzën e tretë të Konsullit britanik në Shkodër dhe patën pesë fëmijë. Dy prej bijve, Attilio dhe Giacinto (autori i dorëshkrimit) hapën shkolla italiane në Shkodër dhe ndritën me karrierën e tyre. Në vitin 1855 u ngul në Shkodër edhe i ati i doktor Siminit, Giacinto, ku ndërroi jetë në moshën 74 vjeçare dhe u varros në Shkodër. Më pas edhe eshtrat e çiftit Simini u prehën në varrezën e Rrëmajit deri sa u tërhoqën për në Monteroni të Leçes në fund të viteve 1960.

Foto 1. Harta tipografike britanike e Shkodrës (1913)



Simini do të na shpjegjë tek një tjetër referencë e trashëgimisë sonë kulturore, Varrezat e Rrëmajit që gjendet në periferinë lindore të qytetit. Ata janë unikale në llojin e tyre në vendin tonë, arsye për të cilën janë shpallur monument kulture në vitin 2007. Varreza të besimit katolik, familjare, ndërtime me karakter monumental që i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX, në kohën kur Shkodra kishte marrë zhvillim të dukshëm. Shumë prej varreve janë ideuar e arkitektuar nga Kol Idromeno. Janë të dekoruara me ornamente të stilit neoklasik dhe shpesh edhe me skulptura prej mermeri, kolona mermeri, me kapitela si dëshmi e madhështisë së familjes së cilës i përkasin. Materialet e përdorua si granit, mermer, çimento, pjesë metalike me gonxha janë të një cilësie të lartë.¹⁹ Kryesisht përdoren gurë vendi për të formuar një shkëmb si dëshmi e të qenit autoktonë, familje shkodrane (rasti i familjes Çeka-Suma). Karakteristike është larmia arkitekturale dhe ornamentale që i jep vlerë artistike kësaj varreze, por pa anashkaluar atë historike, sepse aty prehen korifejtë e artit, kulturës e shkencës mbarë kombëtare.

Përfundime

Jo në vend të mbylljes, por të ideve për të ndërtuar një qasje ndryshe ndaj të shkuarës, kulturës, historisë, trashëgimisë sonë në tërësi. Disa ide që kërkojnë vetëm vullnet pozitiv për të shkruar e për të mos e harruar atë që lamë pas, sepse pa të djeshme nuk ka kurrë të ardhme.

Gjurmimi i personazheve historike që shfaqen në kujtimet e Siminit ndihmon në rindërtimin e mozaikut të një Shkodre të dikurshme që koha e ka prishur dhe dëmtuar. Fisi Bonatti nga Korfu i vendosur në Shkodër, Pashko Vasa, Marubbi, udhëtarët e piktorët e huaj të shekullit XIX që vizituan Shqipërinë, janë personazhe historikë e kulturorë, fati i të cilëve ndërthurej së bashku duke prodhuar art e kulturë për qytetin.

Kujtimet e sjella nga autori, ashtu siç i ka arkivuar në memorie nga rrëfimet e babait, tregojnë shumë referenca bibliografike mbi jetën zakonore dhe vështrimin antropologjik të Shkodrës së asaj kohe, mbi tolerancën fetare, mbi komunitetin italian të rrënjësuar në jetën e qytetit që la gjurmë në trashëgiminë tonë kulturore materiale dhe jo materiale,

¹⁹ Dibra Zenepe (2018), *Qyteti që lindi nga një kështjellë*, Lezhë, Botimet Fishta, fq.209

mbi jetën diplomatike të Shkodrës kur asokohe mikpriste përfaqësitë e shteteve të mëdha evropiane.

Një libër kujtimesh i thjeshtë në dukje evokon shumë ngjarje e personazhe e mund të shërbejë si një guidë për promovimin kulturor të qytetit. Shumë nga objektet e evokuara nuk ekzistojnë sot, prandaj analiza e këtij teksti është apel për institucionet kulturore politikbërëse në nivel lokal e qendror. Një pllakat ndihmon në rindërtimin e identitetit tonë kulturor. Sepse identiteti ndërtohet edhe nga vendet që ne vizitojmë.

BIBLIOGRAFIA

- BEDENI LUCIAN (2021), *Foto-Studio "Marubbi" shpi themelue në 1856 : (Pietro Marubbi dhe lindja e studios së parë fotografike në Shqipëri)*, Tiranë
- BUSHATI HAMDI (2005), *Shkodra dhe motet*, vëllimi I, Shkodër, Rozafa 1
- BUSHATI HAMDI (1999), *Shkodra dhe motet*, vëllimi II, Shkodër, shtëpia botuese "Idromeno"
- DIBRA ZENEPE (2018), *Qyteti që lindi nga një kështjellë*, Lezhë, Botimet Fishta
- KAMSI WILLY (1994), *Monumentet e traditës në Shkodër*, në "Seminari i parë ndërkombëtar 'Shkodra në shekuj', 22-23 qershor 1993
- KERÇIKU KADRI (1962), *Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shek. XVIII-XX*, Tiranë
- KOLIQI ERNEST (2003), *Familja Simini*, në "Vepra 6", Prishtinë, Faik Konica
- LEAR EDWARD (2008), *Edward Lear në Shqipëri. Ditar udhëtimesh 1848-1849*, Tiranë, Plejad
- LEJEAN GUILLAUME (2011), *Udhëtimeve në Ballkan (1857-1870)*, Dituria
- LUZATI SKENDER (1998), *Ndërtimi dhe arkitektura e Shkodrës gjatë shekujve*, në "Seminari i dytë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", 22-23 qershor 1995
- NUSHIQ BRANISLLAV (2021), *Nga Kosova deri në bregdetin Adriatik. Shënime udhëtimi nëpër viset shqiptare në vitin 1894*, Naimi
- QVICK ULLMAR (1998), *Shkodra në botimet e vizitorëve suedezë*, , në "Seminari i dytë ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", 22-23 qershor 1995
- SIMINI GIACINTO (2011), *Un Patriota Leccese Nell'Albania Ottomana*, Argo
- SIMINI GIACINTO (2021), *Një patriot leçez në Shqipërinë osmane*, përkth. nga origj. Alma Hafizi, Tiranë, Berk
- SIMINI GIACINTO (2017), *Albania, viaggio nel paese delle aquille*, LB Edizioni
- SUMA TEREZINA (2003), *Familja Suma, histori, traditë, etikë*, Florimont